

DRITAN NASI

PASHALLËKU I MËNDAFSHIT VIBRUES

HISTORIA (SEKRETE) E ALI PASHËS

NOVELË GRAFIKE

BOTIMET TOENA

Dritan Nasi

Pashallëku i mëndafshit vibrues

Historia (sekrete) e Ali Pashës
novelë grafike



BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Eris Rusi

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Mirjana Madhi

Ilustrimet: Dritan Nasi

ISBN: 978-9928-376-40-4

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al



Prologu

Anija turistike e ishujve

Të gjithë personat e grupit turistik nxituan të hipnin në autobusin që hapi dyert para tyre. Indriti u ul në ndenjësën e tij, aty diku nga mesi. Pas pak nga altoparlanti u dëgjua zëri i sigurt dhe i qetë i shoqëruesit: - Bashkë do të jemi në një udhëtim treditor në zonën e Itakës, do të shëtisim në disa prej ishujve të tjerë të detit Jon, më pas në Prevezë, Pargë dhe Janinë. Gjatë udhëtimit do të ndjekim gjurmët e lëna nga Ali Pashë Tepelena, Veziri i Madh, siç e quanin, - vazhdoi të shpjegonte shoqëruesi nga mikrofoni i autobusit, - Ali Pasha arriti të krijonte një pashallëk të madh, i njohur si më i rëndësishmi në Ballkan, ku sundoi për një periudhë 30-vjeçare. Rëndësia që fitoi ky pashallëk, kohëzgjatja e sundimit dhe pozicioni gjeografik, e nxitën Napoleon Bonapartin të lidhte marrëveshje të shumta tregtare me të.

Rrëfimi i shoqëruesit po bëhej interesant, ndërsa heshtja i përfshiu të gjithë, teksa shikonin me vëmendje dhe dëshirë rrugët dhe ndërtesat e Nikolos, qytetit të vogël bregdetar, që kalonte me shpejtësi pas xhamave. Ata kishin mbërritur një ditë më parë nga Tirana, duke ndjekur planin e udhëtimit katërditor me një nga agjencitë e shumta turistike që ishin hapur në kryeqytet.

Ishin në modë këto udhëtime, pasi jepnin mundësinë e marrjes së informacioneve të shumta dhe siguronin vizita edhe në vende të rralla, ku i vetëm zor se mund të shkoje. Në programin e ditës ishte planifikuar udhëtimi me anije në tre nga ishujt e shumtë të detit Jon. Porti i vogël nga do të niseshin gjendej vetëm disa kilometra larg hotelit ku kishin kaluar natën. Disa minuta më vonë, pas disa kthesash të forta, autobusi u fut në një parkim, ku si sfond kishte detin dhe disa anije të vogla turistike.

- Thuhej që ai konsiderohej për nga rëndësia dhe fuqia si numri dy pas Sulltanit, - vazhdoi shpjegimin historik shoqëruesi i grupit. - Ishte një titan në epokën e titanëve. Aliu kishte një buxhet tejet të konsiderueshëm, që krahasohej me buxhetin e madh të Portës së Lartë. Ai mundësoi ndërtimin e dhjetëra kalave, qyteteve të fortifikuara, moderne e madhështore. Ky është një vit i rëndësishëm, - vazhdoi shpjegimin shoqëruesi, - pasi janari shënon dhe 200 vjet nga koha e prerjes së kokës së Ali Pashës.

Nga CD-ja e autobusit, pa mbaruar shpjegimi, filluan të dëgjoheshin tingujt e këngës së njohur “Të shtrinë Ali të shtrinë, trupi në Janinë, koka në Stamboll”; zërat burrorë dhe tingujt e solos së klarinetës ushtuan si për të shoqëruar fjalinë e fundit.

- Nga dritarja po shikojmë anijen që do të na shëtisë gjatë ditës sonë të parë, - mbaroi fjalën e tij shoqëruesi, ndërsa vëmendja u përqendrua drejt anijes së bardhë turistike me tri kate, që ishte ancoruar në portin e ishullit të Lefkadës, dhe me hapjen e derës, pasagjerët e harruan për pak çaste këngën dhe historinë 200-vjeçare.

Jashtë, ajri përvëlues i goditi në fytyrë si afshi i dalë nga një furrë e nxehtë, megjithëse aroma e detit ishte freskuese. Uji kishte ngjyrë smeraldi të thellë, në atë zonë mes ishujve, tipike për detin Jon. Indriti ngjiti shkallët e tragetit turistik dhe u ul në katin e tretë, aty ku hapej shikimi 360 gradë i pamjes së detit dhe ishujve. Ai gjeti një ndenjësë në stolin e gjatë, në verandën e sipërme. Tragetit u shkëput qetësisht nga bankina e portit me dridhjet e lehta të helikës, të cilat filluan të përçoheshin në të gjithë trupin e tij në mënyrë të sinkronizuar me tingujt e muzikës, që mbushnin verandën e tragetit. Gumëzhitja e helikës duke marrë gaz në momentet e para të shkëputjes nga bregu, vinte në lëvizje një rrymë uji krejtësisht transparente dhe gjithë ky elektrizim i çasteve të para të shkëputjes nga bregu, filloi t’i jepte një

gjendje meditimi. Lëkundjet dhe dridhërima që i përcilleshin trupit të tij sikur transmetonin momentin e nisjes në udhëtim. Ndihehin vetëm pak lëvizje të lehta nga dallgët e vogla, të cilat përplaseshin me bashin e metaltë të tragetit. Aroma e detit në orët e para të ditës përzihej në qiellzën e tij me aromën e kafesë së porsa pirë, duke përkundur shpirtin si në një ëndërr mëngjesore. Afër ishin ulur një grup vajzash të bukura, të rregulluara deri në detajet më të vogla, me veshje gati transparente dhe elegante që më shumë zbulonin sesa mbulonin, thuajse do të shkonin të pozonin për ndonjë revistë mode.

Të gjitha figurat femërore lëviznin para syve të tij si të ishin para objektivit të një aparati fotografik profesional, në një set fotografik që kushton dhjetëra mijëra euro. Mes tyre dalloheshin veshje linoje me kolor pastel që ndërthureshin si në një pikturë, me rripa dhe lidhje fjongosh që dukeshin sikur ishin duke bërë lojën “më shikon, s’më shikon” mbi format e rrumbullakosura trupore. Mes tyre spikaste një rreth i artë vezullues. Medaljoni prej ari rrumbullakosej plot hijeshi dhe në pjesën e brendshme ngjante si një pasqyrë që reflektonte botën përballë në formë të artë. Medaljoni lëvizte ngadalë me ritmin e lëkundjes së anijes mes dy sferave të harkuara në mënyrë perfekte të gjoksit të vajzës, pjesë e atij grupi, që qëllloi rastësisht ulur pranë Indritit. Lëkundja e anijes, e përforcuar

tashmë nga ritmi i medaljonit të artë, krijoi një përhumbeje të lehtë në mendimet që rrotulloheshin në kokën e tij.

“Shumë tunduese do të ishte për çdo burrë të shikonte foton e tij të lëkundej mes asaj butësie”, mendoi ulur në ndenjësën e stolit të gjatë në verandën e katit të tretë. Medaljoni me pasqyrën e artë ishte shenja se ajo vajzë e kishte zemrën të lirë për të marrë brenda saj një fatlum.

“Ky do të jetë kuptimi që i ka dhënë stilisti atij medaljoni”, mendoi sërish në heshtje, teksa vazhdoi të shikonte me kënaqësi lëkundjen e varësës në atë kornizë të përkryer.

Valëzimi i rrezeve të diellit mbi ndërthurjen e lëkurës me veshjet e linosë dhe varëset e arta, shtonin ndriçimin shkëlqyes, duke u shndërruar në diçka fosforeshente. Shikimi i tij ngeci si në një rrjetë elegante merimange të veshjet e linosë së atij grupi vajzash. Ato të gjitha ngjasonin ose të krijonin përshtypjen e një imazhi oriental, ose si të dala, të shkëputura nga një pikturë romantike, që tregon e ngjason me oazat e veshura me mermer, mes të cilave lëvizin figura femërore, thuajse mitologjike.

“Situatë gati megalitike”, mendoi dhe qeshi me vete. Si një arredues i kujdesshëm, ai inkudroi pamjen e shfaqur para tij. Distanca nga medaljoni deri te qendra e barkut të saj ishte çuditërisht e vogël. Të gjitha format ishin krejt perfekte. Por distancat

ishin jonormale, çka e bënte të gjithë trupin e saj një harmoni krejt të ngjashme me një “Kapriçio” të Paganinit. Gjithçka filloi t’i ngjasojë si një grup instrumentesh muzikore që luanin, interpretonin një muzikë të veçantë hipnotizuese. U kujtua se në kulmim e fuqisë së tij, Ali Pasha lëvizte shpesh me varka mes këtij deti magjepsës, ku ishte përhumbur dhe Odiseja, për vite e vite me radhë, gjatë pjesës më të bukur të jetës së tij.

Në kuvertën e sipërme, ulur në stolin me panoramë të gjerë, në anijen që do të vizitonte thuajse të gjithë ishujt magjepsës të detit Jon, Indriti ishte humbur krejt në mendime, duke shijuar çdo çast dhe çdo lëkundje të tragetit turistik. Tenda e verandës vibronte lehtë nga puhiza e detit. Përballë tij tani ishte krijuar një kompozim me gjashtë vajza, siluetat elegante të tyre përziheshin me format e njëra tjetrës, por të gjitha ishin të ndërlidhura magjishëm. Në sinkron me njëra-tjetrën trupat e tyre krijonin një materie të re për mendimet e tij. Ai grup elegant i transmetonte ndjesinë sikur ishte duke udhëtuar në ndonjë jaht modern luksoz, dhe jo në një anije normale turistike. Mes tyre i tërhoqi vëmendjen vajza e veshur me kostum të bardhë.

“Kostum’ do të ishte fjalë shumë e madhe”, mendoi në heshtje. Veshja apo “kostumi i bardhë” përbëhej nga pantallona të gjata që fshinin dyshtemenë metalike të tragetit, me një gjatësi

të dukshme, rreth tre gishta që preknin tokën, si dhe një shalli të ngjashëm me një çerek xhakete me kopsa. Pjesa e sipërme ishte e kundërt me pantallonat, aq e shkurtër sa i lejonte barkut të saj të tërhiqte vëmendjen e pasagjerëve të tragetit. Linoja e pantallonave, shumë e hollë nga mbrapa dhe e bërë njësh me format e saj, u kthye në një kurth vdekjeprurës për shikimin e tij. Dy vajzat e tjera, veshur me lino, i qëndronin pranë si në një pikturë të Botiçelit. Njëra që gjendej gati ngjitur tij mbante veshur pantallona ngjyrë të verdhë ulliri, ndërsa tjetra qëndronte në këmbë, me veshje ngjyrë mente të thellë pothuajse smerald. Veshja e saj kombinohej me byzylykun e perlave dyngjyrëshe, që i vareshin me delikatesë në kyçin e dorës.

Një tjetër vajzë e kolme, qëndronte me një buzëqeshje të përhershme që ishte kthyer gati në një mbështjellje të buzës së sipërme. Përmasat e saj i kujtuan këngën e Mamicës që kishte dëgjuar pak më parë në autobus.



Hamami i madh

Gjethet kishin filluar të zverdheshin të gjitha, duke bërë që pemët të ktheheshin dalëngadalë në një kurorë degësh të thata. Aliu, Veziri i Madh, ishte në vitin e tij të 20-të të sundimit mbi pashallëkun e fuqishëm të Janinës, që shtrihet në të gjithë pjesën jugore të Ballkanit. Ishte një vjeshtë e vonë e vitit 1820 dhe Pashai sapo kishte mbushur 78 vjeç. Fuqia e tij shtrihej edhe tej hapësirave të pamata të pashallëkut të tij, duke lëshuar hije valëzuese edhe mbi kryeqendrat e Europës dhe Azisë. Në Stamboll, Paris, Londër dhe Moskë përsëritej shumë shpesh emri i tij në konfigurime nga më të çuditshmet. Nga ministrat e thesareve të këtyre vendeve dilnin shuma të mëdha në monedha ari për ta mbështetur apo për ta luftuar, por akoma më shumë për ta hequr qafe këtë luan me mjekër të gjatë dhe të bardhë. E gjithë kjo atmosferë Euro-Aziateke, nuk ndikonte shumë në funksionimin e pashallëkut të madh. Mbi malet dhe fushat e tij nuk frynte kjo

erë kontinentale, por në të gjitha ato hapësira tejet të gjera të Ballkanit Jugor pëshpëriteshin, dhe ishin politikë e ditës, vetëm gjendjet emocionale të Pashait të Madh. Humori i tij ishte gjëja më e rëndësishme për të gjithë klimën, për të gjithë punonjësit e administratës së tij të madhe, që ishte organizuar në mënyrë perfekte, mjeshtërisht, sikur të ishte oborri i sarajit të pronarit nga një fshat i vogël i Tepelenës. Të gjithë zgjoheshin në mëngjes duke pritur të shikonin si do të ishte buzëqeshja e Pashait të Madh, dhe shtriheshin duke menduar sesi kishte qenë në fund të ditës humori në fytyrën e tij. Prej saj, varej jeta dhe fundosja.

Në sarajin e Ali Pashës ardhja e grupit më të ri të konkubinave kishte sjellë disa turbullira. Gjetja e tyre ishte vërtet mister, e shëmbëllente më intriguese nga të gjitha historitë e robinjave të tjera. Ato ishin gjetur në një zonë të thellë, krejt të izoluar nga gjithë rrugët e rëndësishme të pashallëkut të madh. Ajo ishte zona ku përfaqësuesit e Pashait shkonin vetëm një herë në vit, për të mbledhur rentën e Pashait, që vinte në formën e gëzofëve të çmueshëm të dhelprave. Kjo zonë e përtejme e pashallëkut, në kufijtë më të largët që takoheshin me botën sllave, mbahej, si zona ku rriteshin dhelprat gri, më të vështirat për t'u gjuajtur, kjo si rrjedhojë e zgjuarsisë së tyre të rrallë.

Tregohej se këto dhelpra, ndikuar vetëm nga era që linin gjahtarët në ambient, arrinin të kujtonin edhe pas dy vitesh lëvizjet dhe shtigjet që kishte

ndjekur secili gjahtar për një periudhë disavjeçare. Pikërisht nga kjo zonë, flitej që qehallarët me shilte brezi prej ari, kishin gjetur krejt rastësisht karrocën, në të cilën gjendeshin brenda tri bionde dhe një brune. Ato flisnin një gjuhë sllave të përzier me turqishten. Ndihmuar edhe nga kjo histori kaq intriguese për t'u treguar, ato shpejt ishin shndërruar në vajzat më misterioze dhe magjike të sarajeve. Të gjitha vajzat e tjera vinin nga zona të njohura që rrisnin dhe sillnin vajza të bukura, sipas përrallave dhe rrëfenjave që tregoheshin dhe këndoheshin nga rrëfimtarët më në zë të kohës, duke u njohur nga të gjithë. Hyrja në oborrin e ngushtë pranë hamamit të madh ku lahej vetë Pashai, pa pasur një histori që tregonte një “produkt” të vlerësuar, ishte diçka e jashtëzakonshme, gati në kufijtë e të pamundurës. Pashai i Madh kishte aq pasuri, sa konsumonte çdo gjë që ishte e markës më të mirë.

I gjithë oborri, administrata, deri në periferitë e pashallëkut, ishin shumë të interesuar për të parë ndryshimet dhe sesi do të integroheshin të porsaardhurat në hamamin e madh të pashallëkut. Ata ishin të vetëdijshëm se nga çastet që kalonte Pashai në orët e pushimit në hamam, ndikohej shumë humori i ditës. Nga ky humor më pas varej i gjithë funksionimi i këtij shteti që për punonjësit e administratës konsiderohej si një saraj i madh. Haremi dhe hamami i madh ishin institucionet më të rëndësishme të strukturës së qeverisjes.



Turistët në guralecët e bardhë të Itakës, labirinti ujon i detit Jon

Trageti turistik vazhdonte të lëkundej lehtë, ndërsa Indriti po shikonte i përqendruar se si po afrohej ai plazh i bardhë, i vogël, rrethuar me shkëmbinj të thepisur, që ngriheshin vertikalisht në të tria anët e rërës së formuar nga guralecët e vegjël të bardhë, plot vezullim. Në pjesën e përparme, plazhi ndërpritej nga ngjyra turkeze, e thellë e detit. Ishte si një përrallë që bëhej realitet, të prekje një breg të drejtë, rrethuar nga shkëmbinj të thepisur e dallgë. Një realitet që ngjante si një vegim që e ndieje se do të zhdukej shumë shpejt, si të ishte ishulli i sirenave. Në altoparlantin e anijes u dëgjua zëri i kapitenit që përsëriste në tri gjuhë të ndryshme, dhe së fundmi shqip: - Mos iu afroni për asnjë arsye shkëmbinjve, rrezikoni jetën tuaj nga shkëmbinjtë që shkëputen. Ky është ishulli i Itakës, vendlindjes së Odisesë. Qëndrimi në ishull do të zgjasë 60 minuta, duhet të jeni në bord 5 minuta para orës 12:00.

Indriti nxitoi të zbriste shkallët për t'u larë me grupin e parë që do të futej në ujë. Teksa takoi këmbët mes guralecëve të imët që përbënin rërën e ishullit, i erdhën në mendje disa krahasime dhe si brenda një ëndrre të bukur dëgjoi zërin e tij së brendshmi:

“Kështu duhet të jenë ndier lundëtarët e vjetër që provonin një lumturi shumë të madhe kur preknin tokën pas një udhëtimi të gjatë. Por lumturia e tokës ishte akoma më e madhe, pasi e dinin se ishte e përkohshme dhe nuk do të zgjaste pafundësisht. Toka për ta ishte vetëm një ëndërr, e cila do të vazhdonte jo më shumë se disa orë. Ky ishte një breg prej të cilit duhej të largohesh pa pasur asnjë mundësi për qëndrim të gjatë, pavarësisht sa shumë mund të pëlqehet. Gjithë kjo i jepte një epsh të brendshëm çdo veprimi që bënte në atë plazh të shkretë, si dhe larja në detin që ngjante i përbërë nga një lëng magjik që rridhte rreth trupit të tejnxehur nga vapa në anije. Dukej sikur mundesh, për një periudhë të shkurtër kohe, të shijoje vite të jetës sate në atë plazh të izoluar nga qytetërimi. Por gjithçka do të mbaronte shpejt. Ishte një udhëtim në kohë, ku ndihesh si Odisea në vitet e tij më energjike për të shijuar jetën. Ali Pasha duhet të ketë kaluar në këtë labirint detar, gjysmë ishullor, me vezullimet çorientuese dhe me aromën dehëse, por kjo ka ndodhur kur ishte në vitet që i mungonte